

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur INSTAT-in si prodhuesin kryesor të statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, misioni i të cilit është të prodhojë statistika asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve për proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale të vendit;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm censin e bujqësisë, i cili ndër të tjera ka për qëllim të sigurojë informacion të përgjithshëm dhe të detajuar për të gjitha njësitë ekonomike bujqësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe të krijojë regjistrin statistikor të njërive ekonomike bujqësore;

Duke vlerësuar se përdorimi i teknologjisë së informacionit është i rëndësishëm për të përmirësuar proceset e prodhimit statistikor dhe në të njëjtën kohë ndihmon në integrimin e burimeve të ndryshme të të dhënave dhe në përmirësimin e përpunimit të tyre;

Duke inkurajuar forcimin e bashkëpunimit të INSTAT-it me prodhuesit e statistikave zyrtare, si dhe shtimin e numrit të agjencive të sistemit statistikor kombëtar, në funksion të shtimit të numrit të statistikave;

Shqyrtoi veprimtarinë e Institutit të Statistikave për vitin 2025 dhe vlerëson:

Punën e bërë për hartimin e një kornize strategjike për përdorimin e metodave moderne në prodhimin statistikor, e cila synon të sigurojë statistika më të shpejta, më të detajuara dhe më të përshtatura me nevojat e përdoruesve, duke garantuar njëkohësisht standardizim metodologjik, cilësi të lartë dhe integritet të të dhënave, në përputhje me praktikatat evropiane dhe ndërkombëtare.

Punën e bërë për publikimet tematike “*Post Census*”, konkretisht analizat me tema: “Fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri”, “Romët dhe egjiptianët në Shqipëri”, si dhe “Profili i personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri”, si analiza të cilat u përgjigjen nevojave të politikave publike, planifikimit vendor dhe kërkimit shkencor.

Punën e bërë si anëtar i grupit negociator, përgjegjës për Kapitullin 18 “Statistikat”, në kuadër të integritimit evropian.

Punën e bërë për përgatitjen e materialeve orientuese dhe tutoriale për përdorues joteknikë, si video shpjeguese, për përdorimin e *Geodata Hub* dhe *WebGIS*, dhe udhëzuesi për përdorimin e *Dashbordit* të bashkive, ku treguesit janë të gjithë të njëjtë dhe të disponueshëm për të 61 bashkitë, duke ofruar në këtë mënyrë mundësi krahasimi ndërmjet vetë njërive të vetëqeverisjes vendore.

Nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes INSTAT-it dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), e cila synon zhvillimin e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike në fushën e statistikave zyrtare përmes organizimit të trajnimeve të integruara.

Punën e bërë në përditësimin dhe mbajtjen aktive të faqes zyrtare të INSTAT-it, si mjeti kryesor për shpërndarjen e informacionit statistikor zyrtar, i cili siguron akses të barabartë të publikut ndaj të dhënave dhe publikimeve të INSTAT-it.

Bashkëpunimin e INSTAT-it me institucionet e arsimit të lartë, institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet private, me qëllim sigurimin e qasjes më të gjerë në burimet e të dhënave dhe rritjen e mbulueshmërisë së aktiviteteve të kërkimit dhe inovacionit. Në të njëjtën kohë konsideron të rëndësishëm zgjerimin e gamës së treguesve statistikorë të publikuar në faqen e tij zyrtare, duke ofruar të dhëna më të detajuara për aktivitetin kërkimor dhe inovativ të ndërmarrjeve dhe të institucioneve kërkimore në vend.

Kuvendi i Shqipërisë rekomandon që Instituti i Statistikave për vitin 2026 në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të intensifikojë punën në kuadër të procesit të integritimit evropian për përafrimin brenda vitit 2027 të standardeve të reja të përcaktuara në rregulloren (BE) 223/2009 për qeverisjen e të dhënave, përdorimin e të dhënave nga sektori i biznesit dhe të dhënave të tjera administrative në përmbushjen e piketave përkatëse të kapitullit 18 “Statistikat”.

2. Të marrë të gjitha masat e nevojshme lidhur me censin e ekonomive bujqësore duke vënë pranë Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat kalendarin e punëve dhe burimet e financimit për çdo operacion. Pas miratimit të projektligjit “Për censin e bujqësisë” nga Kuvendi, t’i kërkoher menjëherë qeverisë mbështetja financiare për realizimin e censit të ekonomive bujqësore në përputhje edhe me *acquis*-n e BE-së.

3. Të paraqesë brenda vitit 2026 projektprogramin e statistikave zyrtare për periudhën 2027–2031 duke mbajtur në konsideratë prodhues të rinj të statistikave zyrtare dhe statistikat lidhur me dhunën në familje;

4. Të ndërmarrë hapa për përmirësimin inovativ të infrastrukturës së prodhimit statistikor, përditësimin e sistemeve *hardware* dhe *software* të institucionit në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), me qëllim forcimin e sigurisë ndaj sulmeve të mundshme kibernetike.

5. Gjatë vitit 2026, edhe me mbështetjen e donatorëve, të ketë prioritet të punës përditësimin e platformës së Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke shtuar të dhënat dhe duke zgjeruar mbulimin statistikor.

6. Të rrisë përpjekjet institucionale në drejtim të përmirësimit të përpilimit dhe transmetimit të të dhënave plotësisht në përputhje me ESA 2010, të intensifikojë në mënyrë të veçantë bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë për të bërë të mundur adresimin e anomalive të konstatuara në të dhënat e raportuara për Procedurën e Deficitit të Tepruar (EDP) dhe Statistikat Financiare të Qeverisë (GFS) duke shtuar numrin e *datapoint*-eve që transmetohen në Eurostat.

7. Pas marrjes së informacionit të plotë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor të marrë masa për organizimin gjatë vitit 2026 të anketës në shkallë të plotë për transportin rrugor të mallrave.

8. Të marrë masat e nevojshme për plotësimin e vendeve vakante në strukturën e miratuar në vitin 2025 për të garantuar funksionimin normal të institucionit. Duhet rritur përpjekjet për përmirësimin e procesit të rekrutimit, shpërblimit të punonjësve dhe trajnimit të tyre, krijimit të një ambienti konkurrues, transparent për rritjen e tyre në detyrë, duke bërë të mundur krijimin e një stafi i cili ka eksperiencën dhe profesionalizmin e nevojshëm për përballimin e sfidave me të cilat përballlet institucioni.

9. Për të bërë të mundur zgjerimin, fuqizimin dhe përmirësimin e statistikave financiare monetare dhe ekonomike të ketë në vëmendje rritjen e bashkëpunimit ndërinstitutional, si dhe shtimin e numrit të agjencive të sistemit statistikor kombëtar.

10. T’i kushtojë rëndësi bashkëpunimit dhe komunikimit me Komisionin për Ekonominë, Punësimin dhe Financat. Ky komunikim/bashkëpunim duhet të jetë i vazhdueshëm dhe më profesional.

11. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit në funksion të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3-mujorit të tretë të këtij viti.

12. Të sigurojë zbatimin në kohë të rekomandimeve dhe vendimeve të institucioneve të pavarura duke raportuar periodikisht çdo 4 muaj në Kuvend për masat e ndërmarra dhe statusin e zbatimit të tyre në përmbushje të detyrimeve institucionale, si dhe standardeve evropiane.

13. Të konsolidojë mekanizmat e transparencës institucionale, duke forcuar funksionin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe duke garantuar publikimin e informacionit sipas standardeve të të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të informacionit të sektorit publik.

Miratuar në datën 16.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi